

Menaxhimi i Shkollës, Rasti Shqiptar

Titulli i rastit

Keqmenaxhimi i konflikteve me mësuesit

Fusha dhe niveli i arsimit nga është marrë rasti

Menaxhimi i konflikteve në arsimin parauniversitar

Përshkrimi i rastit

Në 24 tetor të vitit 2015, DAR- Elbasan, paralajmeron largimin nga puna të zonjës M.K, drejtore e vendosur në këtë funksion në prill 2014, me motivin: “Për mosrealizim të detyrave funksionale duke çuar në mosmenaxhimin e situatave konfliktuale të krijuara ndërmjet mësuesve në shkollë”.

Që në fillimet e punës, mësuesit kanë pasur ankesa për aftësitë menaxheriale të drejtoreshës, ankesa këto të bëra të ditura pranë DAR në mënyrë gojore.

Në qershor 2015 ankimimet janë bërë zyrtare nëpërmjet letrave të dërguara nga mësueset e shkollës në DAR dhe MAS, bërë publike në gazetën “Panorama.

Letrat e mëposhtme drejtuar DAR në lidhje me drejtoreshën e shkollës M.K. janë shkruar nga tre mësuese të kësaj shkolle në periudhën qershor 2015-shtator 2015, të cilat pretendojnë se drejtoresha ka ushtruar mbi to dhunë fizike, verbale dhe psikologjike. Këto letra janë bërë publike edhe në media.

Ankimimi 1. Më 15.06.2015, E. L., mësuese e dalë në pension dërgon pranë DAR- Elbasan letrën me numër protokollit 154. E. L. kishte shkuar në shkollë për të takur ish nxënësit dhe kolegët e saj por është nxjerrë jashtë në mënyrë të dhunshme. Në letrën e saj mësuesja pensioniste citon se, përveçse u dhunua fizikisht, më tepër i dhemb lëndimi moral dhe ka kërkuar që të merren masa ndaj M. K.. Por sipas mësueses, edhe pse është njoftuar Drejtoria Arsimore Rajonale, ky institucion nuk ka marrë asnjë masë.

Ankimimi 2. Një tjetër leter ankimimi për drejtoren e shkollës M.K. drejtuar DAR- Elbasan, është shkruar nga S. K. (mësuese në këtë shkollë) për sjellje konfliktuale e mosmenaxhim të marrëdhënieve me stafin. S. K. është mësuesja që kërkon të ndërhyhet nga autoritetet duke marrë masat e duhura. Dinjiteti i mësuesve është përdhosur edhe gjatë mësimit, përmendet në ankesë, ku mësuesja është shtyrë dhe sharë në sy të nxënësve.

Ankimimi 3. Letra e fundit është shkruar nga F.T. dhe ajo i është drejtuar Ministres së Arsimit. F. T. paraqet fakte konkrete për mungesë menaxhimi të shkollës nga drejtuesja, si: ndarja jo e drejtë e orëve mësimore, mosnjohje e dokumentacionit, caktimin e mësuesit kujdestar, hartimin e planit vjetor të shkollës, mungesë e theksuar të etikës së komunikimit, vlerësim situatash me dy standarde, mungesë organizimi, etj.

Përcaktime ligjore

Duke u bazuar në Ligjin e Arsimit Parauniversitar . 69/2012, Kreun IX për statusin e personelit mësimor, Neni 54, pika 2.ç, përcakton se “drejtori i institucionit arsimor publik ose privat, është përgjegjës për menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për

zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit”, gjë që duket se nuk është realizuar nga M.K, gjatë periudhës që ajo e ka ushtruar këtë detyrë.

Neni 55 “Aspekte të menaxhimit” i Dispozitave Normative, në pikën 3 përcakton se”Drejtori, pas këshillimit me këshillin e mësuesve: a) vendos ndarjen e klasave; b) cakton ngarkesën mësimore të mësuesve; c) cakton mësuesit kujdestarë; harton vetë ose ngarkon një nëndrejtor/mësues për hartimin e orarit javor mësimor të institucionit.

Ndrësa në Nenin 122 të Dispozitave Normative përcatohet se :DAR/ZA-ja: a) zbaton Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar në kushtet vendore; b) bashkëpunon me njësinë bazë të qeverisjes vendore; c) vëzhgon procesin mësimor dhe menaxhimin e institucionit arsimor;

Procedura e ndjekur dhe vendimi i DAR- Elbasan

Pas njohjes me ankesat, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka dërguar një grup inspektimi që së bashku me ekipin e monitorimit të DAR Elbasan, kanë kryer verifikime pranë shkollës “Jeronim De Rada”, Elbasan.

Nisur nga konstatimet e kryera nga këto dy grupe, në tetor të vitit 2015, DAR- Elbasan, paralajmëron largim nga puna të zonjës M.K, drejtore e vendosur në këtë funksion në prill të vitit 2014, me motivin: “Për mosrealizim të detyrave funksionale duke çuar në mosmenaxhimin e situatave konfliktuale të krijuara ndërmjet mësuesve”. Pas këtij vendimi si dhe disa seancave ballafaqimi e këshillimi me qëllim shuarjen e konflikteve gjendja në shkollë nuk është stabilizuar dhe DAR Elbasan ka nisur procedurat për largimin nga puna të M.K.

Burime

<http://www.panorama.com.al/denoncimi-nga-punonjese-burgu-behet-drejtore-she-shkolle-kap-per-fyti-mesuesen/>

<http://www.panorama.com.al/dar-reagon-per-drejtoren-e-dhunshme-mesueset-rrahen-njera-tjetren/>

<http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/ligje/ligji-nr-69-2012-per-sistemin-arsimor-parauniversitar-ne-republiken-e-shqiperise&page=1>

<http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/parauniversitar/dispozitat-normative.pdf>